



Instituti i Kosovës për Drejtësi

Për: z. Ramush Haradinaj, Kryeministër
Ministrat e Qeverisë së Republikës së Kosovës

Nga: Ehat Miftaraj – Drejtor Ekzekutiv
Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD)



17 qershor 2019

I nderuari Kryeministër i Republikës së Kosovës, z. Ramush Haradinaj,

Më lejoni që përmes kësaj shkrese të adresojë shqetësimet e Institutit të Kosovës për Drejtësi (IKD) lidhur me Vendimin Nr. 10/104 të miratuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës, më 23 maj 2019, për ndarjen e mjeteve financiare në vlerë prej 95.000 euro, për hartimin e akteve nënligjore dhe përgatitjet e nevojshme për zbatimin e Ligjeve për Reformën e Administratës Publike.

IKD njeh përpjekjet e qeverisë së Kosovës dhe rëndësinë për të finalizuar kornizën ligjore lidhur me zbatimin e reformave në administratën publike, sikurse fuqishëm i mbesim besnik parimit, se vendimet e qeverisë duhet të bazohen në parimet që sigurojnë dhe promovojnë sundimin e ligjit dhe qeverisjen e mirë.

Nga analiza e IKD-së lidhur me vendimin e lartë-përmendur rezulton se qeveria e Kosovës ka vepruar në kundërshtim me këto parime, duke miratuar një vendim që është në kundërshtim me ligjet e aplikueshme në Kosovë, duke dhënë kompensim shtesë për një kategori të caktuar të shërbyesve civil për të kryer detyra dhe përgjegjësi që sipas ligjit të njëjtit janë të obliguar t'i realizojnë gjatë orarit të punës. Për më tepër, lista e personave që përfitojnë nga një vendim i tillë i qeverisë janë kryesisht pozita të larta në shërbimin civil, ku shumica kanë pozitën e drejtorave apo udhëheqësve të divizioneve apo zyrave tjera në Zyrën e Kryeministrit apo ministrive të caktuara.

Në këtë drejtim, sipas pikës 2 të këtij vendimi, këto mjete ndahen nga rezerva e Qeverisë – shpenzimet e paparashikuara, dhe barten në Ministrinë e Administratës Publike (MAP) në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve me qëllim të kompensimit për punë shtesë dhe jashtë orarit të anëtarëve të komisionit të themeluar me vendim të qeverisë, në shumë prej 500 eurove në muaj. Po ashtu, sipas pikës 2 të këtij vendimi, me nga 300 euro në muaj do të kompensohen anëtarët e grupeve të punës që do të themelohen me vendim të Sekretarit të Përgjithshëm të MAP-it.

I nderuari Kryeministër, për arsyet e poshtë shënuara, një vendim i tillë konsiderohet se është kundërligjor dhe jo i drejtë, dhe se kjo kundërligjshmëri dhe padrejtësi mënjanohet vetëm me një hap të vetëm dhe konkret, e që është anulimi i këtij vendimi.

Ky vendim është nxjerrë, ndër të tjera, duke u bazuar në nenin 92, paragrafi 4 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës, i cili përcakton se *“Qeveria merr vendime në pajtim me këtë Kushtetutë dhe me ligje....”*

Neni 29 i Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë të cilit ky vendim edhe i referohet flet vetëm për rastet kur ministria mund të kërkojë fonde shtesë (*fondet e paparashikuara*). Pjesa tjetër e këtij neni, nuk e arsyeton asnjë nga pikat e këtij vendimi. Por, është vetë ky ligj, i cili e ndalon nxjerrjen e vendimeve si në rastin konkret.

Neni 80 i Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë përcakton shprehimisht se:

“Nëse një punonjës, shërbyes civil ose zyrtar i një autoriteti publik ose organizatë buxhetore, sipas një akti të Qeverisë, kërkohet që të shërbejë në një komision, bord ose organ apo autoritet tjetër publik, ky punonjës, shërbyes civil ose zyrtar nuk ka të drejtë të pranojë, dhe nuk do të pranojë, kurrfarë kompensimi shtesë për këtë shërbim. Shërbimi konsiderohet pjesë e detyrave të obligueshme të postit të cilin e mban punonjësi, shërbyesi civil ose zyrtari i sipër cekur”.

Në anën tjetër, Ligji për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, në nenin 44 përcakton se *“Puna e nëpunësit civil kompensohet përmes sistemit të pagave, i cili rregullohet me ligj të veçantë”.*

Nga ky arsyetim, kuptohet qartazi se punonjësit, shërbyesit civil dhe zyrtarët e autoritetit publik, në rastin konkret të shërbyesve civil që përfitojnë nga ky vendim, për punën e tyre pranojnë pagën e tyre mujore, dhe çdo kompensim tjetër mbi këtë bazë, është hiç më pak se përfitim i dyfishtë. Pra, kemi të bëjmë me dhënie dhe marrje të kundërligjshme të kompensimeve, që sipas vendimit në fjalë, arrinë vlerën totale në shumë prej 95.000 euro.

Në këtë drejtim, fakti se ky vendim është i kundërligjshëm është bazë e mjaftueshme që i njëjti të anulohet në momentin e parë. Por, për më tepër, i njëjti vendim është edhe i padrejtë dhe jo meritator, për arsye se i mundëson disa personave që për punën e njëjtë të marrin edhe pagën edhe kompensimin, derisa të tjetër marrin vetëm njërën prej tyre.

Andaj, i nderuar Kryeministër i Republikës së Kosovës z. Ramush Haradinaj, me qëllim që të eliminohet kundërligjshmëria brenda pushtetit ekzekutiv të Republikës së Kosovës, të mënjanohet padrejtësia dhe jo meritokracia, të ruhet paraja publike dhe të ipet shembull i mirë për të ardhmen, IKD me anë të kësaj letre kërkon që në kuptim të kompetencave tuaja si i pari i Qeverisë, të anuloni këtë vendim, para se i njëjti të fillojë të prodhojë efekte – pasoja për buxhetin publik, ndërsa nëse deri më tani veçse ka filluar efektet - pasojat, i njëjti të anulohet retroaktivisht.

Për arsyet e sipërpërmendura, shpresojmë se kërkesës tonë do t'i përgjigjeni pozitivisht, duke anuluar këtë vendim që në rastin e parë.

Me respekt,